



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 274, datë 29.05.2024

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN
ADMINISTRATIVE TË APELIT PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME
VENDIMIN NR.235, DATË 24.05.2023, PËR KANDIDATEN ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, i ndryshuar, si dhe në pikën 36, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatës për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e relatorit të çështjes,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023 për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR